



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**  
**SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT**

Prishtinë, më 24.09. 2018

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 21 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; nenit 6, 10, 11, 12 dhe 13 të Rregullores Nr. 02/2018 së Njësisë Ligjore; Sekretaria shpall

## **KONKURS**

### **për plotësimin e vendit të punës**

**1.**

**Pozita:** Këshilltar kushtetues juridik (junior)  
**Kodi:** GJ-DL 04-09  
**Numri i vendeve të punës:** 2 (dy)  
**Kohëzgjatja e kontratës:** Pa afat  
**Puna provuese:** 1 (një) vit

### **Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës**

Nën mbikëqyrje të Këshilltarit të Parë kushtetues juridik dhe të gjyqtarëve përkatës, mbështet punën profesionale të këshilltarëve të lartë kushtetues juridikë (junior) dhe të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza dhe duke ndihmuar në hartimin e vendimeve, të raporteve dhe të materialeve të tjera juridike të hartuara nga Gjykata Kushtetuese.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore**

- Mbështet punën e këshilltarëve të lartë kushtetues juridikë;
- Hulumton dhe studion literaturë përkatëse kushtetuese-ligjore të nivelit vendor dhe ndërkombëtar;
- Hulumton dhe kërkon informacione të nevojshëm, *inter alia*, të vendimeve të gjykatave të tjera kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Përgatit analiza krahasuese në bashkërendim me këshilltarët e lartë kushtetues juridikë;
- Kontribuon në funksionimin efikas dhe efektiv të Njësisë Ligjore si dhe kryen detyra që kërkon këshilltari i Parë kushtetues juridik;

## **Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme**

- Përgatitje e avancuar universitare në shkencat juridike, preferohet ekspertizë në të drejtën publike, në të drejtën kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut;
- Së paku 3 vjet përvojë profesionale juridike;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.

Kandidati për pozitën e Këshilltarit kushtetues juridik (junior) duhet të ketë njohuri të thella profesionale, si dhe aftësi të shkëlqyeshme hulumtuese dhe analitike.

Po ashtu, kandidati duhet të demonstrojë qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve adekuate me burime të kufizuara; të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me shkrim); të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet; të ketë aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe me ndjeshmëri me kolegë dhe me palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit dhe të hulumtimit në internet.

Kandidati duhet të njohë gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar.

## **Informata të përgjithshme për kandidatë**

Përcaktimi i pagës, për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e punës dhe me vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta punësimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe e të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procedurës së rekrutimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## **Procedura e konkurrimit**

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: **[www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)**.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet emailit në adresën: **[lulzim.syla@gjk-ks.org](mailto:lulzim.syla@gjk-ks.org)**, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve, nëpërmjet emailit, nëpërmjet shërbimit postar apo në Zyrën e Personelit të Gjykatës Kushtetuese, është më **08.10.2018, në orën 16:00.**

**Shënim:** Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen, kurse do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.